

Në përgjigje të email-it Tuaj të datës 18.03.2020, Ju informojmë se:

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, dega Rajonale Elbasan gjatë muajve Janar-Shkurt 2020, ka kryer 67 inspektime në zbatim të Ligjit Nr. 8528, datë 23.09.1999 “Për nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me gji”, të ndryshuar dhe të Ligjit Nr 9942, datë 26.06.2008 “Për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut”, të ndryshuar.

Këto inspektime janë kryer në subjekte të tregtimit të këtyre produkteve nëpërmjet portalit e-inspektimi. Për arsye të uljes së barrës së inspektimit, në subjektet që i tregtojnë të dyja produktet (64 subjekte), është kryer një inspektim, duke shkarkuar në sistem të dyja listë verifikimet për zbatimin e ligjeve të mësipërme. Janë vendosur 3 Masa Administrative me gjobë ndaj subjekteve që janë gjetur në shkelje.

Bashkëngjitur do të gjeni procedurën inspektuese në subjektet ndaj të cilëve janë marë masat administrative, të nxjerra nga portali e-inspektimi.

Jemi në dispozicionin tuaj për cdo pyetje apo paqartësi, në se keni.